

VENDIM
Nr. 573, datë 29.8.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT
“MAUZOLEU I FAMILJES MBRETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikës e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitin 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në artikullin 231 “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, t’i shtohet fondi i përgjithshëm prej 20 825 999 (njëzet milionë e tetëqind e njëzet e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh, për ndërtimin e objektit “Mauzoleu i Familjes Mbretërore”, Tiranë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ministria e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha